
**Raporti përmbledhes i vlerësimit të cilësisë nga studentët
për vitin akademik 2021/2022
Programi: Arkitektura e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve**

1. Hyrja

Në këtë raport është paraqitur vlerësimi i cilësisë nga studentët në programin Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve, i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë të raportit është paraqitur vlerësimi i përmbledhur për program, dhe staf akademik. Në pjesën e dytë të këtij raporti është paraqitur dhe përshkruar në mënyrë të detajuar, vlerësimi i programit Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve, i ndarë në vite.

Raporti i përmbledhur i vlerësimit të cilësisë

Nga raporti i përmbledhur i paraqitur në tabelën nr. 1 në kuadër të fushës së vlerësimit të programit, gjegjësisht të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke iu referuar tabelës, shifet se si pasojë e pandemisë (Covid 2019), kishte një rënie të lehtë, po që në vitin 2021/2022 trendi fillon të normalizohet. Ndërsa, te vlerësimi i stafit akademik, bazuar në tabelën e mëposhtme, shohim që rezultati është i kënaqshëm për tri vitet e fundit akademike.

Tabela.nr.1 Vlerësimi i cilësisë sipas fushave

	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Vlerësimi i Mësimdhënies dhe mësimnxënies (programit)	3.99	4.02	4.05*
Vlerësimi i stafit akademik	4.36	3.96	3.87




Figura nr. 1 Trendi i vlerësimit të cilësisë sipas fushave

1.1 Raporti i vlerësimit të Programit për vitin akademik 2021/2022

Vlerësimi i programit është realizuar përmes pyetësorëve të ndarë në 2 sesione: Vlerësimi i Mësimdhënies dhe Mësimnxënies i cili përmban 21 komponente. Zakonisht ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e programit përkatës. Pyetjet për dy sesionet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- pajtohem pjesërisht; 4- pajtohem; dhe 5- pajtohem plotësisht). Rezultatet e vlerësimeve të këtyre sesioneve janë paraqitur në këtë raport përmes tabelave nr. 2, dhe 3.

Tabela nr. 2 Mesimdhënia dhe Mësimnxënia

	Viti aktual	Vitet paraprake	
	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave na jepen rregullisht	4.08	4.46	3.99

Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	4.19	3.82	4.25
Përmbajtja e lëndës (syllabusi) na shpërndahet me kohë	4.19	4.4	4.17
Orari i konsultimeve me profesorë është i shpallur	4.06	4.06	3.99
Orari i konsultimeve me profesorë respektohet	3.98	4.4	3.89
Që në fillim të vitit jemi të njoftuar me mënyrën e vlerësimit me lëndën përkatëse	4.20	4.46	4.29
Metodat e mësimdhënies janë bashkëkohore	3.98	4.46	4.00
Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shumë nga ai në klasë	3.63	3.33	3.28
Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për dhe i plotëson nevojat e studentëve	3.97	3.58	4.34
Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për konkretizimin e mësimi	3.92	4.13	3.96
Raporti në mes të pjesës teorike dhe laboratorike(praktike) të lëndëve është adekuat	3.84	4.2	3.74
Studenti është i lirë që vetë të përcaktohet për lëndë zgjedhore	3.78	3.96	4.34
Orari i mësimi shpallet me kohë	4.06	3.93	4.22
Orari i shpallur i mësimi respektohet nga mësimdhënësit	4.08	3.96	4.07
Programi i studimit është aktual me zhvillimet në këtë disiplinë te studimit	4.11	3.69	3.99
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në universitetet e tjera	4.02	3.42	3.91
Vlera e ECTS-së për lëndën është e llogaritur sipas ngarkesës së studentit	4.06	4.2	3.87
Puna praktike jashtë institucionit aplikohet me rregull	3.70	3.86	3.62
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	3.84	3.54	3.68

Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitivë	4.13	4.33	4.10
Këtë program të studimit do t'ia sygjeroj edhe personave të tjerë	4.13	4.31	4.05

Bazuar në rezultatet e vlerësimit, te sesioni Mesimdhënia dhe Mësimnxënia të paraqitura në tablën nr. 2, vërejmë se të gjitha komponentet e këtij sesioni janë vlerësuar nga studentët mbi 3,68, që ka një rënie të lehtë në vitin 2020/21, sepse ishte vit i pandemisë dhe për shkak të kufizimeve, puna praktike ka qenë e vështirë të realizohej.

Tabela nr.3 Vlerësimi i stafit dhe lëndëve përkatëse

	Viti aktual	Vitet paraprake	
	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Syllabusi i lëndës, i cili përfshinë përmbajtjen dhe mënyrën e vlerësimit, më është prezantuar në mënyrë të detajuar në fillim të semestrit	4.4	4.0	3.7
Vijimi i mesimdhënësit gjatë semestrit ka qenë i rregullt dhe në kohë	4.3	4.0	3.9
Mësimdhënësi ka ardhur gjithmonë i përgatitur në mësim	4.4	4.0	4.0
Aktivitetet gjatë semestrit kanë krijuar mundësi që studentët të angazhohen në diskutime, aktivitete kreative, si dhe është inkurajuar ndërveprimi i studentëve (puna në grupe, dyshe, etj).	4.3	3.9	3.8
Mësimdhënësi ka qenë në dispozicion të studentëve për konsultime, ne Universitet apo online	4.4	3.9	3.8
Mesimdhënësi i inkurajon mendimet e ndryshme të studentëve dhe i respekton ato	4.4	4.0	3.9
Materialet e ofruara për studime gjatë semestrit ishin të pershtatshme për fitimin e njohurive dhe të shkathtësive të parapara për këtë lëndë	4.3	3.9	3.8

Materialet e ofruara nga mësimdhënësi janë publikuar me kohë në SMU, Teams apo në Moodle	4.4	4.0	3.8
Studentët kanë qenë të informuar paraprakisht për kriteret e vlerësimit të provimit/punimeve ose të punës së tyre në përgjithësi	4.4	4.0	4.0
Vlerësimi i punës së studentëve për lëndën gjatë semestrit është bërë sipas syllabusit të lëndës	4.4	4.0	3.9
Nëse mësimi është mbajtur në klasë, mjetet e konkretizimit (markerat, projektori, tabela, etj) dhe hapësira e mësimi kanë qenë në dispozicion dhe janë shfrytëzuar mirë nga mesimdhënësi	4.4	3.9	3.8
Mësimdhënësi ka përdorur platformën virtuale të mesimit Microsoft Teams dhe mundësitë e saj me lehtësi	4.3	4.0	4.0
Lënda ka qenë e dobishme për studentët	4.4	4.0	4.0

Bazuar në tabelën numër 9, shohim se kemi rezultate të përafërta në të tre vitet dhe vlenë të theksohet se gjatë vitit akademik 2019/2020, katër komponente që janë vlerësuar nën 4, në dy vitet e fundit janë përmirësuar dhe trajtuar me kujdes në komitetin e programit përkatës.